REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 738-747/20
Data/Datum. 19.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Blerina Huruglica ***Ekspert Shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***07.10.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***19.10.2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.10.2020. **OE "EL-Bau &Eing Com"SHPK dhe OE"Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"**, ka parashtruar ankesë me nr: **738-747/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **GOE "Aroma Plus"SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan- Ri Tender**" me nr. të prokurimit: **941-20-2219-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **150,000.00 €.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 26.05.2020, data e hapjes së ofertës 19.06.2020, data e njoftimit për dhënien e kontratës 22.05.2020, data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm 22.05.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "EL-Bau &Eing Com"SHPK dhe OE"Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan- Ri Tender"**, me numër të prokurimit: **941-20-2219-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA**

Sa i përket prtendimeve të OE ankuesit "EL-Bau &Eing Com"SHPK:

Arsyeja nr. 1 e Eleminimit, se Ofertes tuaj I mungon ISO Certifikata nOHSAS 18001-2007, per veprimtarin adekuate siç eshte kerkuar ne dosjen e tenderit per siguri dhe pastrim te hapsirave te mbrendshme ju keni prezentuar, ISO OHSAS 18001-2007 per ndertim te larte dhe te ulet.

Përgjigje e arsyeje nr,2 : më dt.01.07.2020, keni kërkuar sqarime lidhur me ketë pike dhe ne ju kemi pergjigjur si në vijim : ***Lidhur me piken* 1.** Certifikata për siguri në punë dhe e shëndetit OHSAS 18001:2007 e OE "EING COM" të cilën e keni prezantuar nuk është e fushëveprimit adekuat, pasi që ka të bëjë me ndërtim të lartë dhe ndërtim të ulët dhe nuk ka të bëjë me pastrim.

Pergjigje lidhur me Kerkesen nr 1. Ju Njoftojme se grupi I OE ka plotesuar kete pike duke ofruar qertifikaten ISO 45001:2018 Pasi qe certifikata OHSAS 18001:2007 eshte zavendsuar me ISO 45001:2018 per arsye se qertifikatat OHSAS 18001:2007 do te jene te vlefshme deri 10.03.2021 dhe nuk do te kete me trup qertifikuese OHSAS 18001:2007 por do te kaloje ne ISO 45001:2018 per kete ju ofrojme edhe deklaraten informative nga trupa qertifikuese.

Arsyeja nr. 2

- **Ne aspektin tekniko-profesional eshte kerkuar nga AK se OE pjesmarres ne kete tender duhet te ofroj kontrata te natyres se ngjashine, ju ne oferten tuaj keni prezantuar nje kontrate nje numer 651/18/2551/511, sipas LPP-se numri 5 jane kontrata per pune e jo per sherbime te pastrimit te brendshem. Komisioni gjithashtu ka analizuar edhe kushtet e pergjithshme te kesaj kontrate e cila eshte shkarkuar nga e-prokurimi ku qarte verehet se kjo kontrate ka te beje me furnizime te** ndryshme **dhe pune ndertimore e asgje me sherbime te pastrimit.**

Përgjigjeje e arsyeje nr/2, për te plotesuar kete kerkese siq e keni kerkuar ne Dosjen e tenderit: **Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), të lidhura me Institucionet Publike ose Private në vlerë prej jo më pak se 100,000.00 Euro. Ne** kemi baskangjitur dy referenca **me** Titull: Mirembajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapsirave tjera publike ne qytetin e Lipjanit, dhe referencen tjeter "Mirembajtaj dhe rregullimi I parqeve, hapsirave te gjelbruara dhe shesheve, ne teritorin e komunes se Obiliqit"

Ndersa tek paramasa shkruan nr, rendor 2. Pastrimi dhe mirembajtja e hapsiarave te jashtme dhe te gjelbruara te UKZ, shtrohet pytja se si nuk kemi mundur ta plotesojme kete kerkese kur ju te njejten keni kerkuar ashtu siq edhe kemi sjelle referenca.

Arsyeja nr. 3

- **Oferta e juaj permban dy cmime, nje cmim ne formularin e paraqitjes se tenderit dhe**

nje cmim ne analizen financiare, qe jane te ndryshme njera me tjetren.

Pergjigjeje per arsyjen nr.3 ,Nuk është e vertet se oferta e jone permban dy qmime sepse ne ne paramasen te cilen e kemi ofruar dhe formularin e tenderit kemi paraqitur qmimin prej 137,625.24 euro, ndersa ne analizen financiare ne veq ju kemi treguar vetem se si kemi ardhur deri te qmimi ofertues.

Arsyeja 4.

- **Ne analizen financiare per pozicionin numer 6 keni dhene nje sqarim qe shuma e kalkuluar prej 9,735.99 € per pushimet vjetore nuk do t'i kalkulohen Autoritetit Kontraktues sepse kemi punetore me kontrata te tjera ne kompanin tone dhe do te bejme zavendesimin e tyre. Sipas RRUOP-se nje gje eshte e pa pranueshme sepse neni 41.15 pika 2 decidivisht thote: " Nëse Operatori Ekonomik thote se ky artikull është ofruar falas, tcnderi duhet tc refuzohet pasi qe dhuratat nuk janë tc pranucshmc".**

Përgjigjeje per arsyejen nr.4 : Gjate analizes financiare te cilen e kemi bere zavendsimet nuk I kemi kalkuluar fare sepse nuk eshte pergjegjesi e AK se lidhur me zavendsimet e punetoreve sepse ne I pagumi nga AK per njesi matese per meter katror per pastrim, dhe nuk qendron arsyeja se ne I kemi ofruar falas ndonje artikull, por ky kalkulim I kompanis tone eshte ne favor te AK sepse ja kursen afer 10 mije euro AK, Shtrohet pytja po ashtu UKZ nuk punon 365 dite, qe keto zavendsime te pushimeve vjetore behen ne harmoni me pushimet e Universitetit, ndersa kujdestaria ne kete periudh eshte ne pergjegjesi tonen.

Arsyeja nr. 5

Nuk keni llogaritur ndrrimin e nates per nje mirëmbajtës sic eshtc kerkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kerkesa 2 pika e 3-te fq.15, ku thot se: orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 ore 7 dite ne jave per te gjithe vitin.

Pergjigjje per arsyejen nr. 5, më dt. 17.06.2020 nga AK kemi pranuar Njoftimin

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik.
Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.
"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.
Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.
Shtrohet pytja se si keni mundur te na eleminoni per kete pike kur ju te njejten e keni larguar nga Specifikacioni teknik.
Arsyeja nr. 6
Në dosjen e tenderit ne faqe 16 dhe 17 te Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË

DETYRUESHME është kërkuar.

Informatë me rëndësi:

Duhet të jeni në dijeni se Autoriteti Kontraktues e rezervon të drejtën ligjore

për verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara dhe të kërkojë sqarime shtesë dhe verifikime nga çdo ofertues apo autoritet publik i cili i lëshon këto dokumente që kanë të bëjnë me informata para dhënies së kontratës.

Çdo material ose pajisje që është e cekur me emër ose është cekur prodhuesi, ai material ose pajisje mundet me qenë edhe ekuivalente, me specifika të njejta ose më të mira.

Po ashtu ju njoftojmë se kalkulimi i Çmimeve të materialit higjenik do të bëhet në bazë të çmimeve referente të cilat gjenden në web faqen e KRPP-së.

VËREJTJE:

OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analizë do të përfshijë:

1. **Pagat bruto për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
2. **Pagat e përgjegjësve dhe të menaxherit kryesor sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
3. **Vlerën e materialit shpenzues për pastrim sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
4. **Vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
5. **Pagesat e ndërrimeve të natës për mirëmbajtësit sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
6. **Zëvendësimet e punëtorëve me rastin e pushimeve vjetore.**
7. **Vlerën e pajisjeve dhe instalimin e tyre në hapësirat e UKZ-së**

Çmimi jo normalisht i ulët i vlerësuar sipas analizës financiare e bënë tenderit të papërgjegjshëm sipas Nenit 61 të LPP-së.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Çmimi për njësi Pa TVSH	TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	**Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan**	M2	6100 M2			
2	**Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan**	M2	6200 M2			
					Gjithsej	

Autoriteti Kontraktues shihet se në dosjen e tenderit ka paraqitur specifikacione te mangëta dhe jo te plota dhe vlersimi duhet te bëhet sipas kushtev te dosjes se tenderit që janë parapar duke mos përdore asnjë kriter që nuk është paraqitur në dosjen e tenderit po si do që të jet Pozicionet e kërkuar ne Paramase dhe Parallogari kanë qenë

me m2 dhe ne si kompani kontraktuese kemi plotsuar Paramasen siq është kërkuar.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit"EL- Bau&EING COM"SHPK:

1. Neni 1 par.1 dhe 2 (Qëllimi) i LPP-së nr.04/L-042 lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP
2. Neni 6 par.1 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) i LPP-së nr.04/L-042 lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOP;
3. Neni 7 par.1, 2 dhe 4 (Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi) i LPP-së nr.04/L-042 lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;
4. Nenit 51 par.1 i LPP-së nr.04/L-042, lidhur me nenin 26 të RrUOPP;
5. Nenit 56 par.1.1 dhe 1.2 dhe par.3 (Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave) i LPP-së nr.04/L-042, lidhur me nenin 26 të RrUOPP;
6. Neni 59 par.4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) i LPP-së nr.04/L-042, lidhur me nenin 41 pika 3 të RrUOPP;

Gjerësa sa i përket OE ankuesit të dytë "efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë":

Të nderuar, Organ Shqyrtues i Prokurimit

Paraqesim ankesë lidhur me procedurën tenderuesë të aktivitetit numër 941-20-2219-2-1-1 me titull Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan- Ri Tender.

Që nga shpallja publike e këtij aktiviteti kemi analizuar në tërsi dosjen si dhe ndryshimet gjatë fazës tenderuese. Autoriteti kontraktues ka shpallur të pa përgjegjëshme ofertën tonë duke dhëne disa arsyetime të cilat nuk qëndrojn. Arsyetimet që në fakt në vendimin e OSHP-së vet autoriteti ka pranur se ka hecur disa kritere me të cilat është thirrur pas vendimit për ri-velërësim për të eleminuar ofertën tonë.

- Arsyet e eleminimit të ofertës sonë:

Komisioni pas ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave Ka Konstatuar se oferta juaj eshte e pa pergjegjshme sepse, nuk e keni plotesuar Pershkrimin e cmimeve sipas sqarimeve te fundit te dosjes se tenderit, keni ofruar cmim mujor e jo cmim per 36 (muaj) sic eshte kerkuar

tek pershkrimi i cmimeve sipas sqarimeve te fundit ne dosjen e tenderit.

- Nuk keni llogaritur ndrrimin e nates per nje puntor sic eshte kerkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kerkesa 2 pika e 3-te fq. 15, ku thot se: orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 ore 7 dite ne jave per te gjithe vitin.

- Tek pershkrimi i ofertes, analiza financiare keni dhene cmim 140,688.00 €, ndersa komisioni vleresues ka konstatuar se cmimi eshte 142,179.00 €, ju si OE eshte dashur te llogaritni edhe TVSH per 3 pozicionet e tjera (Uniformat, Fitim te planifikuar dhe Material), ju TVSH-n e keni llogaritur vetem ne paga.

Lidhur me pikën e parë për shpalljen të papërgjegjëshme të ofertës sonë shih kërkesa lidhur me vendosjën e çmimeve.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Çmimin për - *njësi Pa* TVSH	TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan	M2	6100 M2			
2	Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadrl Zeka" Gjilan	M2	6200 M2			
					Gjithsej	0

Totall I Përgjithshëm mujor dë të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikës e Kosovës
Duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas analizës financiare.

Lidhur me pikën e renditur 2 ku thuhet se nuk keni kalkuluar kërkesat e dosjes së tenderit për qështjet sociale të punëtorëve shih korigjimin e autoritetit si dhe vendimin pjesë nga vendimi i OSHP-së që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Korigjimi i dhënë nga autoriteti kontraktues

Të nderuar,

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik.
Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim

dhe ujësjellës.

Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Neve nuk arrim ta kuptojm se pse të jetë arsye për eliminim kjo kur vetë keni dërguar korigjim për mos kalkulim të kësaj pike. Por më absurdja që ka ndodhur në këtë "vlerësim" është sepse Vendimi juaj i datës 11.09.2020 lidhur me rekomandimin për dhënje të kontratës, dhe arsyetimet tuaja lidhur me ofertën tonë si të papërgjegjëshme bëjnë që të bini në kundërshtim me kërkesat tuaja ankesat e OE-ve por edhe vendimin e OSHP-së, për arsye se OE i rekomanduar për kontratë në ankesën e dorëzuar në OSHP ka cekur se ka parë korigjimin tuaj për heqjen e kësaj pike ku thotë:

AK UKZ, ne menyre te kunderligjshme ne kundershtim me Ligjin e Prokurimit Publik nenin 62 pika 1.1 1.2 dhe 1.3 e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me tiiuli: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit mbrenda dhe jashte të Universitetit publik "Kadri Zeka" Gjilan RITENDER, Me numer të aktivitetit të prokurimit 941-20-2219-2-1-1 Me numer te mbrendshem të prokurimit:UKZ208-97700/20/010/221. AK per anulimin e ketij aktiviteti te prokurimit eshte thirrur ne ate se eshte bere nje gabim teknik tek specifikime teknike ne faqe numer 15, tek mirembajtja e rrjetit elektrik, kerkesa numer 2 pika 4. ku thuhet se OE duhet te siguroj kujdestari per intervenime emergjente prej se paku 3 puntoreve (mirembajtjes) gjate 24 oreve, elektrik, kanalizim. Ujesjelles. Mirepo AK ne njoftimine dates 17.06.2020 e ka hequr kete pike tek kerkesa numcr 2, piken numer 4 tek specifikimet teknike ku thote se:"pasi qe nuk eshte e domosdoshme dhe eshte bere nje gabim gjate pergaditjes se dosjes se tenderit. Kjo kerkese eshte hequr nga AK pasi qe nje OE ka bere pyetje rreth kesaj pike. Pyetjen te cilen e bene OE MSS ka te beje me ate se kompania a duhet te siguroj kujdestari 24 ore per 3 te punesuar. AK ka dhene kete pergjigje.

Te nderuar,
Ju njoftojme se numri i pergjithshem eshte 9 punetore ashtu sic eshte cekur ne specifikimet e dosjes se tenderit, mirepo me vone permes e-prokurimit, kemi paranuar nje njoftim nga AK per OE, per nje gabim teknik tek faqja numer 15 (mirembajtja e rrjetit elektrik) kerkesa numer 2 tek pika numer 4, ku thuhet se cdo OE qe duhet te siguroj kujdestari per intervenime emergjente per se paku 3 puntore (mirembajtes) gjate 24 oreve elektrike, kanalizimi dhe ujsjelles, te hiqet nga specifikimet teknike tek kerkesa pika numer 4 Anulimin e ketij aktiviteti AK e arsyeton ne letren standarde per tenderues te pasuksesshem e arsyeton se ka pasur pa qartesi dhe huti tek ofertuesit, shtrohet pytje se cilat jane ato pa qartesi dhe huti tek OE te na i sqaroni. Po ne qoftese ka pasur paqartsi dhe huti tek OE ata kane pasur mundesi te bejne pyetje te pakten 5 dite para hapjes se ofertave por asnje OE nuk ku bere pyetje edhe AK para hapjes ka pasur mundesi te beje ndryshime ose ta nderprej ta anuloj kete aktivitct te prokurimit per shkak te ngjarjeve objektive dhe shkaqeve te tjera qe dalin jashte kontrollit dhe nuk mund te parashikohen ne kohen e inqizimit te aktivitetit te prokurimit, sic e parasheh ligji i prokurimit neni 62 pika 1.3.
Gjithmone ne fuqi mbetet versioni apo sqarimi i fundit i AK pa marre parasysh se a eshte hequr nga dosja e tenderit apo jo.

AK tek letra standarde per tenderues te pasuksesshem thot se kemi bere njoftimin per permiresimin e gabimit teknik po nuk e kemi hequr nga pozicioni tek dosja e tenderit dhe pershrimi i cili ka shkaktuar paqartesi dhe huti tek ofertuesit, mirpo AK ketu i ka ngaterruar gjerat sepse behet fjale vetem per kerkesen numer 2 pika 4, e pytjen te cilen e ka parashtruar OE eshte se:"Kompania a duhet te siguroj kujdestari 2 per 3 punetoret", Eshte vet kerkesa e AK-së tek kushtet e veqanta, mandej tek faqja 15 kerkesa numer 2 pika numer 3 ku thuhet se orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 dite ne jave per gjate tere vitit dhe pershrimi i cmimeve nga AK qe cdo OE te jep nje analize financiare ku perfshihen:

OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te cmimi përfundimtar e ku kjo analizë do të perfshijë:

1. **Pagat bruto për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshi edhe TVSH sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
2. **Pagat e pergjegjësve dhe të menaxherit kryesor sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
3. **Vleren e materialit shpenzues per pastrim sipas specifikacionit në dosje tenderit.**
4. **Vlerën për uniformat verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosje tenderit.**
5. **Pagesat e ndërrimeve te natës per mirëmbajtësit sipas specifikacionit në dosje të tenderit.**
6. **Zëvendësimet e punëtorëve me rastin e pushimeve vjetore.**
7. **Vlerën e pajisjeve dhe instalimin e tyre në hapsirat e UKZ-së**

Në një pytje drejtuar KRRP-së lidhur me intepretimin e gjendjes së till thuhet së:

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuardhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron sqarimin e dispozitave të LPP-së dhe të legjislacionit dytësor si në vijim:

Në *përputhje* me paragrafin 4 të nenit 27 të LPP-së, **Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë duhet të jenë identike.**

Gjithashtu,

Në përputhje me nenin 18.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, **Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.**

Si rrjedhojë, paragrafi 4 i nenit 27 të LPP-së si dhe neni 18.4 i RRUOPP detyrimisht

kërkojnë që **Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë të jenë identike,** për faktin se një mospërputhje e Kërkesave të specifikuara në dokumente te tenderit *(Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë)* si në rastin konkret do të përbënte mosrespektim të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor të përmendura më lartë,si dhe mos respektim të parimeve themelore të prokurimit publik ***(barazia në trajtim jo diskriminimi konkurrenca dhe transparenca).***

Për të gjithë operatorët ekonomik që pretendojnë se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, si dhe në përputhje me dispozitat e LPP dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Me respekt,
Arbnora Cakolli-Luzha,
Kordinatore e Departamentit të Rregullave-KRPP.

Arsyetimi i tretë i dhën si ndryshim aritmetik më arsyetimin se nuk kemi kalkuluar tvsh sipas Ligjit mbi tatimin e shtuar. Nuk ka rregull ligjore që e rregullon çështjen e faturimit të tvsh në materialin higjienik, dhe në uniforma të punës sepsë të dyja këto janë pagësa të cilat OE pagun palëve të treta në këtë rastë si rregull tvsh është e ribursueshme nga ATK.

Autoriteti kontraktues me datën 17.09.2020 ka vendosur lidhur me ofertat duke shpallur ofertën tonë të pa përgjegjëshme me arsyetimet e dhëna më lartë. Ne kemi shtruar sipas procedurës kërkesë për ri-shqytim duke paraqitur pretendimet tona por AK ka refuzuar kërksën me arsyetimin e njëjt.

Ne praqesim këtë ankesë duke shprehur pretendimet tone së janë shkelur dispozitat e LPP-së, kriterët dhe ndryshimet e dosjës së tenderit si dhe vendimi i OSHP-së si dhe çdo parim ligjorë.

Ne besojm se oferta jonë është e përgjegjëshme duke plotësuar cdo kërkesë të dosjës së tenderit. Andaj, kërkojm që ti aprovoni pretendimet tona ankimore që AK të kthej lëndën në ri-vlerësim.

<u>Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit të dytë ""efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë":</u>

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 61Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
Vendimi i OSHP-së i datës: 21.08.2020

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakti – Dosja e Tenderit pika 7.1&7.2

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **Kërkesa 1 . Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1. Certifikata e Regjistrimit te biznesit - Kopje**
		Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH-së.	**Dëshmia 2. Certifikata e TVSH - kopje**
		Kërkesa 3. Certifikata e numrit fiskal	**Dëshmia 3. Certifikata e numrit fiskal – kopje**
		Kërkesa 4 . Certifikatë për siguri në punë dhe e shëndetit OHSAS 18001 2007	**Dëshmia 4. Kopje e certifikatës OHSAS 18001-2007**
		Kërkesa 5 . Kërkesa 4 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015	**Dëshmia 5. Kopje e certifikatës EN – ISO 9001 2015.**

Fakti – Dosja e Tenderit pika 9.1&9.2

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), të lidhura me**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1. Një liste të kontratave të realizuara, duke saktësuar , titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e kontratës dhe përfituesin.** **Lista e kontratave të jetë e nënshkruar dhe e vulosur.**

		Institucionet Publike ose Private në vlerë prej jo më pak se 100,000.00 Euro.	**Kryerja e kontratave në Institucionet Publike të dëshmohet me referenca apo pranime teknike.** **Ndërsa kryerja e kontratave në Institucionet Private të dëshmohet me fatura të paguara apo me deklarata tatimore.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pas ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave ka konstatuar se në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 8 operator ekonomik, prej të cilëve tre operator ekonomik kanë qenë të përgjegjshëm dhe pesë operatorët e tjerë kanë qenë të papërgjeshme.
Sa I përket vlerësimit se pse operatorët ekonomik kanë qenë të pa përgjegjshme janë të cekura më lartë tek analiza e çmimit ku në detaje janë treguar arsyet se pse janë refuzuar.

Andaj, komisioni rekomandon që Grup i Operatorëve Ekonomik: " AROMA PLUS " SH.P.K.; SCHAFBERGER JR.GMBH, ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit I cili ka ofertuar ni vlerë prej 149, 580.00 Euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit "EL-Bau &Eing Com"SHPK:

Pretendimi i 1 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 1 e Eleminimit të OE ankuesit në Letrën standarde është:" Ofertes tuaj I mungon ISO Certifikata OHSAS 18001-2007, per veprimtarin adekuate siç eshte kerkuar ne dosjen e tenderit per siguri dhe pastrim te hapsirave te mbrendshme ju keni prezentuar, ISO OHSAS 18001-2007 per ndertim te larte dhe te ulet.

Përgjigja e ankuesit tek arsyeje nr.1 : më dt.01.07.2020, keni kërkuar sqarime lidhur me ketë pike dhe ne ju kemi pergjigjur si në vijim : ***Lidhur me piken* 1. .** Ju Njoftojme se grupi I OE ka plotesuar kete pike duke ofruar qertifikaten ISO 45001:2018 Pasi qe certifikata OHSAS 18001:2007 eshte zavendsuar me ISO 45001:2018 per arsye se qertifikatat OHSAS 18001:2007 do te jene te vlefshme deri 10.03.2021 dhe nuk do te kete me trup qertifikuese OHSAS 18001:2007 por do te kaloje ne ISO 45001:2018 per kete ju ofrojme edhe deklaraten informative nga trupa qertifikuese.

Eksperti Shqyrtues lidhur ne pretendimin e parë sqaron, se në ofertën e GOE ankuesit **"EL-Bau &Eing Com"SHPK** janë të bashkangjitura tek oferta Certifikatat, ku OE ka sqaruar se Cretifikata OHSAS 18001:2007 është zëvendësuar me ISO 45001:2008, dhe po ashtu tutje Eksperti sqaron se në E-prokurim edhe

disa OE të tjerë kanë dhënë shpejgime për këtë certifikatë, mirpo mbetet nën kompetencë të AK-së që të verifikoj këtë Cerrtifikatë nga Autoritetet Kompetente, andaj ky pretendim i OE ankuesit **gjendet pjesërishtë i bazuar**.

Kettenhofweg 1, 60325 Frankfurt am Main, Germany www.ebsgmbh.com

ISO 45001:2018 transition information for clients

The new standard ISO 45001 was published on 12 March 2018. With this release, OHSAS 18001:2007 will be withdrawn, maximum expiration date of OHSAS 18001:2007 certificates will be 10.03.2021. Companies certified to the OHSAS 18001:2007 standard have to transition their certificate to ISO 45001:2018.

We inform you with this letter that OHSAS 18001:2007 is equivalent to ISO 45001:2018 until 10.03.2021.

Kind Regards.

Quality Manager
M. Collaku

Zertifikat

Certificate

Quality Management System

Certificate No: 1020ERQ

For: **EL BAU SHPK**

Address: LIMON STANECI, GJILAN, REPUBLIC OF KOSOVO

Assessment Scope: Low general construction and infrastructure, concrete with concrete products, electrical installation with maintenance, maintenance of public spaces, public buildings with technical and hygienic maintenance.

International Standard: ISO 9001:2015, Quality Management System

Issue: 01, Certification date: 05 June 2020
Date of issue of the certificate: 05.06.2020
Date of validity of the certificate: 04.06.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 14.05.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit,
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1020Q
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung,Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem
QMS ISO 9001:2015

Authorized, Signature

Zertifikat

Certificate

Occupational Health and Safety Management System

Certificate No: 1020ERO

For: **EL BAU SHPK**

Address: LIMON STANECI, GJILAN, REPUBLIC OF KOSOVO

Assessment Scope: Low general construction and infrastructure, concrete with concrete products, electrical installation with maintenance, maintenance of public spaces, public buildings with technical and hygienic maintenance.

International Standard: ISO 45001:2018, Occupational Health and Safety Management System

Issue: 01, Certification date: 05 June 2020
Date of issue of the certificate: 05.06.2020
Date of validity of the certificate: 04.06.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 14.05.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit,
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1020O
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung,Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem
OHSAS ISO 45001:2018

Authorized, Signature

Zertifikat

Certificate

Environmental Management System

Certificate No: 1020ERE

For: **EL BAU SHPK**

Address: LIMON STANECI, GJILAN, REPUBLIC OF KOSOVO

Assessment Scope: Low general construction and infrastructure, concrete with concrete products, electrical installation with maintenance, maintenance of public spaces, public buildings with technical and hygienic maintenance.

International Standard: ISO 14001:2015, Environmental Management System

Issue: 01, Certification date: 05 June 2020
Date of issue of the certificate: 05.06.2020
Date of validity of the certificate: 04.06.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 14.05.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit,
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1020E
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung,Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem
EMS ISO 14001:2015

Authorized, Signature

Pretendimi i 2 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 2 e eliminimit të OE ankuesit:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "EL-Bau &Eing Com"SHPK dhe OE"Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan- Ri Tender"**, me numër të prokurimit: **941-20-2219-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA**

- **Ne aspektin tekniko-profesional eshte kerkuar nga AK se OE pjesmarres ne kete tender duhet te ofroj kontrata te natyres se ngjashine, ju ne oferten tuaj keni prezantuar nje kontrate nje numer 651/18/2551/511, sipas LPP-se numri 5 jane kontrata per pune e jo per sherbime te pastrimit te brendshem. Komisioni gjithashtu ka analizuar edhe kushtet e pergjithshme te kesaj kontrate e cila eshte shkarkuar nga e-prokurimi ku qarte verehet se kjo kontrate ka te beje me furnizime te** ndryshme **dhe pune ndertimore e asgje me sherbime te pastrimit.**

Përgjigjeja e OE ankuesit tek arsyeje nr.2, për te plotesuar kete kerkese siq e keni kerkuar ne Dosjen e tenderit: **Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), të lidhura me Institucionet Publike ose Private në vlerë prej jo më pak se 100,000.00 Euro. Ne** kemi bashkangjitur dy referenca **me** Titull: "Mirembajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapsirave tjera publike ne qytetin e Lipjanit" dhe referencen tjeter "Mirembajtaj dhe rregullimi I parqeve, hapsirave te gjelbruara dhe shesheve, ne teritorin e komunes se Obiliqit"

Ndersa tek paramasa shkruan nr, rendor 2. Pastrimi dhe mirembajtja e hapsiarave te jashtme dhe te gjelbruara te UKZ, shtrohet pytja se si nuk kemi mundur ta plotesojme kete kerkese kur ju te njejten keni kerkuar ashtu siq edhe kemi sjelle referenca.

Eksperti Shqyrtues lidhur ne pretendimin e dytë sqaron, se në ofertën e GOE ankuesit **"EL-Bau & Eing Com"SHPK** janë të bashkangjitura tek oferta Lista e projekteve dhe po ashtu janë bashkangjitura edhe dy referenca që përkojnë me Mirëmbajtje siq kërkohet në paramasën nr 2, gjerësa OE ankuesi nuk ka bashkangjitur referenca të tjera në mënyrë që ta dëshmoj se I plotëson kriteret, andaj ky pretendim **gjendet I pa bazuar.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATË/A:	25.02.2020
REFERENCË:	
PËR:	"EING COM"SH.P.K.
NGA:	Adem Duriqi, Drejtor i Prokurimit
LËNDA:	REFERENCË PËR PUNËT E KRYERA

Operatori Ekonomik: "EING COM"SH.P.K. nga Podujeva ka nënshkruar kontratë me Drejtorin e Prokurimit në Lipjan për kryerjen e punëve sipas kontratës me titull: **"Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapsirave tjera publike në Qytetin e Lipjanit"**, me numër prokurimit: **613 016 034 221** të datës: 06.07.2016.

Çmimi total i kontratës së realizuar është: **89,935.31€/ 36 muaj**

Departamenti i Prokurimit pran K. Lipjan-it konfirmon se punimet janë realizuar me sukses në cilësi dhe dinamikë, me këtë rast **"EING COM" SH.P.K.** ka treguar profesionalizëm të lartë dhe ka përmbushur me përputhshmëri dhe korrektësi të gjitha kushtet e kontratës si në aspektin teknik dhe dinamik, andaj e rekomandojmë tek Autoritetet tjera Kontraktuese për shërbimet e realizimit të punimeve në projekte të ngjashme.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

REFERENCË

Në bazë të kërkesës së EO: "EING COM", Dumosh, Komuna Podujevë të datës: 17.02.2020 për kontratën dy vjeçare të lidhur me datë: 16.04.2018 në vlerë: **81,727.70€, me Nr.Prokurimit,OB610-18-1048-2-2-1,dhe me Nr. Kontrates XIII-42 te dates** në mes të Komunës së Obiliqit dhe OE: "EING COM", Komuna e Obiliqit lëshon këtë referencë:

OE: "EING COM" me të cilën vërteton se kompania në fjalë ka bërë realizimin e projektit:"Mirëmbajtja dhe rregullimi i parqeve, hapsirave të gjelbruara dhe shesheve në territorin e Komunës së Obiliqit".

Vlera totale e sherbimeve të kryera: **106,657.84** € duke llogaritur edhe punët shtesë.

Kompania në fjalë ka zbatuar në përputhje të plotë kontratën sipas dinamikës kohore dhe sipas planit të paraparë në kontratë, prandaj si të tillë e rekomandojm tek punëdhënësit e ardhshëm.

Menaxheri i Projektit
Bekim Kurteshi

Data
21.02.2020

Drejtori I DMIM

Pretendimi i 3 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 3 e eliminimit të OE ankuesit:

- **Oferta e juaj permban dy cmime, nje cmim ne formularin e paraqitjes se tenderit dhe nje cmim ne analizen financiare, qe jane te ndryshme njera me tjetren.**

Pergjigjeje e OE ankuesit per arsyjen nr.3 ,Nuk është e vertet se oferta e jone permban dy qmime sepse ne ne paramasen te cilen e kemi ofruar dhe formularin e tenderit kemi paraqitur qmimin prej 137,625.24 euro, ndersa ne analizen financiare ne veq ju kemi treguar vetem se si kemi ardhur deri te qmimi ofertues.

Eksperti shqyrtues sqaron se, ofertuesi në paramasën ku duhet të ceket cmimi final I ofertuesit është ai që merret si për bazë, ndërsa Ofertuesi në analizën financiare nuk ka dhënë cmimin e njejt, andaj **Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e gjenë të pa bazuar.**

Pretendimi i 4 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 4 e eliminimit të OE ankuesit:

• Ne analizen financiare per pozicionin numer 6 keni dhene nje sqarim qe shuma e kalkuluar prej 9,735.99 € per pushimet vjetore nuk do t'i kalkulohen Autoritetit Kontraktues sepse kemi punetore me kontrata te tjera ne kompanin tone dhe do te bejme zavendesimin e tyre. Sipas RRUOP-se nje gje eshte e pa pranueshme sepse neni 41.15 pika 2 decidivisht thote: " Nëse Operatori Ekonomik thote se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet te refuzohet pasi qe dhuratat nuk janë te pranueshme".

Përgjigjeja e OE ankuesit per arsyejen nr.4 : Gjate analizes financiare te cilen e kemi bere, zavendsimet nuk I kemi kalkuluar fare sepse nuk eshte pergjegjesi e AK-se lidhur me zavendsimet e punetoreve sepse ne I paguajm nga AK per njesi matese per meter katror per pastrim, dhe nuk qendron arsyeja se ne I kemi ofruar falas ndonje artikull, por ky kalkulim I kompanis tone eshte ne favor te AK sepse ja kursen afer 10 mije euro AK, Shtrohet pytja po ashtu UKZ nuk punon 365 dite, qe keto zavendsime te pushimeve vjetore behen ne harmoni me pushimet e Universitetit, ndersa kujdestaria ne kete periudh eshte ne pergjegjesi tonen.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e katërt sqaron, se pretendimi I OE ankuesit **gjendet I pa bazuar** sepse ne Sepcifikacion kërkohet të përmbushet pozicioni numer 6.

Pretendimi i 5 i OE ankuesit:

Arsyeja nr. 5 e eliminimit të OE ankuesit:

Arsyeja nr. 5

Nuk keni llogaritur ndrrimin e nates per nje mirëmbajtës sic eshte kerkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kerkesa 2 pika e 3-te fq.15, ku thot se: orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 ore 7 dite ne jave per te gjithe vitin.

Pergjigjje e OE ankuesit per arsyejen nr. 5, më dt. 17.06.2020 nga AK kemi pranuar Njoftimin

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik.
Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.
"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24

orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Shtrohet pytja se si keni mundur te na eleminoni per kete pike kur ju te njejten e keni larguar nga Specifikacioni teknik.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e pestë sqaron, se AK ka bërë gjetje tek kërkesa 2 pika 3 "*Orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 ore 7 dite ne jave per te gjithe vitin*" në Faqe 15, ndërsa OE ankuesi e ka shpjeguar pikën 4 në këtë pretendim, e cila nuk përkon me arsyetimin e e eliminimit të AK-së.
Mirëpo Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se OE ankuesi në analizën financiare e ka lënë të hapur këtë pozicion, andaj Eksperti Shqyrtues pretendim e gjenë **të pa bazuar.**

2. **Mirëmbajtja e rrjetit Elektrik:** do te perfshije te gjitha punet e nevojshme elektrike si p.sh. rregullimi i nderprerësve dhe prizave te demtuara, zëvendësimi i ndërprerësve automatik te qarkut, poqave elektrik, armaturave dhe gypave fluoreshent, trupave ndriçues te jashtëm dhe pune tjera te nevojshme elektrike. Gjithashtu është e vlefshme te përmendet se inspektimet ditore do te behet ne menyrë qe te identifikohen problemet/prishjet e mundshme dhe te behet mirëmbajtje preventive.

- Ofertuesi duhet te siguroje te gjithë personelin, pajisjet, materialin dhe kripen industriale për shkrirjen e borës.
- Ofertuesi duhet te siguroje personel te mjaftueshëm për mirëmbajtje te objekteve dhe duhet te organizoj punën ne até mënyrë që shërbimet e kërkuara te realizohen pa ndërprere.
- Orari I shërbimeve te mirëmbajtjes eshte 24 ore ne 7 ditë te javës per gjatë gjithë vitit.
- OE duhet te siguroj kujdestari për intervenime emergjente prej se paku 3 te punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se AK me datën 17.06.2020 ka publikuar njoftimin si mëposhtë:

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

NJOFTIM PËR OPERATORËT EKONOMIK - PËR GABIM TEKNIK

Të nderuar,

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik.

Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

''Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës.

Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Ju faleminderit për mirëkuptim.

Me respekt
Zyra e Prokurimit
Universiteti Publik ''Kadri Zeka '' Gjilan

Afatikohorpër dorëzimin është shkurtuar		Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: Po ☒ Jo ☐ *Nëse po, jep arsyetim:* **Meqenëse jemi në përfundim të kontratës aktuale e cila skadon në Shtator të 2020-tës, dhe për shkak vonesave të mundshme të procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontratës tjetër.**
Hapja e Tendeit	26.1	Hapja e tendeit do te behet me: 19.06.2020 në 14:30:00 ore Vendi: Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Zyra e Prokurimit
Fergjegjshmëria e tendeit dhe dhënies	29.3	
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët ☒
Ankesat	31.3	Universiteti Publik '' Kadri Zeka'' Gjilan, Zyra e Prokurimit

Gjerësa sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit të dytë "efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë":

- Arsyet e eleminimit të ofertës sonë:

Arsyeja e parë : Komisioni pas ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave Ka Konstatuar se oferta juaj eshte e pa pergjegjshme sepse, nuk e keni plotesuar Pershkrimin e cmimeve sipas sqarimeve te fundit te dosjes se tenderit, keni ofruar cmim mujor e jo cmim per 36 (muaj) sic eshte kerkuar tek pershkrimi i cmimeve sipas sqarimeve te fundit ne dosjen e tenderit.

Përgjigja e OE ankuesit te arsyetimi i parë:

Lidhur me pikën e parë për shpalljen të papërgjegjëshme të ofertës sonë shih kërkesa lidhur me vendosjën e çmimeve.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Çmimin për - *njësi* *Pa* TVSH	TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan	M2	6100 M2			
2	Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadrl Zeka" Gjilan	M2	6200 M2			
					Gjithsej	0

Totall I Përgjithshëm mujor dë të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikës e Kosovës
Duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas analizës financiare.

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe analizimit të ofertës dhe kërkesave të AK-së, sqaron se OE ankuesi ka paraqitur përshkrimin e cmimeve sipas formës vjetër duke e kalkuluar cmimin mujor:

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Përshkrimi i çmimeve "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Çmimi për njësi Pa TVSH	TVSH	Çmimi Total me TVSH
1	**Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan**	M2	6100 M2	€ 0.51	18%	€ 3,660.00
2	**Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan**	M2	6200 M2	€ 0.03	18%	€ 248.00
					Gjithsej	€ 3,908.00

Totali i Përgjithshëm Mujor dë të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikën e Kosovës duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas analizës financiare.

Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se në kërkesën e AK-së lidhur me përshkimin e cmimeve, AK ka paraqitur exelin e korrigjuar më datën 15.06.202, ku kërkohet kalkulimi për 36 muaj, dmth komplet cmimi për 3 vite, ndërsa OE ankuesi I eliminuar ka paraqitur gabim:

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Përshkrimi i çmimeve "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Numri i muajve (36)	Sasia Totale për 3 vite	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi në total për 3 Vite
1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan	M2	6100 M2	36	219600		
2	Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të gjelbëruara të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan	M2	6200 M2	36	223200		
						Gjithsej	

Totali i Përgjithshëm Mujor dë të përfshijë të gjitha Taksat e aplikueshme në Republikën e Kosovës duke përfshirë edhe TVSH, si dhe pagat e punëtorëve, materialin për pastrim dhe të tjera sipas analizës financiare.

Andaj pretendimi I OE ankuesit **nuk është I bazuar.**

- **Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankuesit:** Nuk keni llogaritur ndrrimin e nates per nje puntor sic eshte kerkuar tek analiza financiare dhe specifikimet teknike, tek kerkesa 2 pika e 3-te fq. 15, ku thot se"**orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 ore 7 dite ne jave per te gjithe vitin**"

Përgjigja e OE ankuesit për pretendimin e dytë: Lidhur me pikën e renditur 2 ku thuhet se nuk keni kalkuluar kërkesat e dosjes së tenderit për qështjet sociale të punëtorëve shih korigjimin e autoritetit si dhe vendimin pjesë nga vendimi i OSHP-së që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Korigjimi i dhënë nga autoriteti kontraktues

Të nderuar,

Ju njoftojmë se tek Ri tender- Specifikimet Teknike është bërë një gabim teknik.
Gabimi teknik është bërë në faqen 15. Tek mirëmbajtja e Rrjetit Elektrik pika 2.

"Ku thuhet se Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë kujdestari për intervenime emergjente prej së paku 3 të punësuarve (mirëmbajtës) gjatë 24 orëve. Elektrikë, kanalizim dhe ujësjellës"

Andaj, ju njoftojmë se kjo pikë hiqet nga specifikimi teknik pasi që nuk është e domosdoshme dhe është bërë një gabim teknik gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, **se AK ka bërë gjetje tek kërkesa 2 pika 3*"Orari i sherbimeve te mirembajtjes eshte 24 ore 7 dite ne jave per te gjithe vitin*" në Faqe 15,** ndërsa OE ankuesi e ka shpjeguar pikën 4 në këtë pretendim, e cila nuk përkon me arsyetimin e e eliminimit të AK-së**. Andaj ky pretendim nuk gjendet i bazuar.**

2 **Mirëmbajtja e rrjetit Elektrik:** do te perfshije te gjitha punet e nevojshme elektrike si p.sh. rregullimi i nderpreresve dhe prizave te demtuara, zevendesimi i ndërpreresve automatik te qarkut, poqave elektrik, armaturave dhe gypave fluoreshent, trupave ndriçues te jashtem dhe pune tjera te nevojshme elektrike. Gjithashtu eshte e vlefshme te permendet se inspektimet ditore do te behet me menyre qe te identifikohen problemet/prishjet e mundshme dhe te behet mirembajtje preventive.

- Ofertuesi duhet te sigurojë te gjithë personelin, pajisjet, materialin dhe kripen industriale per shkrirjen e borës
- Ofertuesi duhet te sigurojë personel te mjaftueshëm për mirëmbajtje te objekteve dhe duhet te organizoj punën në atë mënyrë që shërbimet e kërkuara te realizohen pa ndërprerje.
- Orari i shërbimeve te mirëmbajtjes eshte 24 ore ne 7 dite te javes per gjithe vitin.
- OE duhet te sigurojë kujdestari per intervenime emergjente prej se paku 3 te punesuarve (mirembajtes) gjate 24 orëve. Elektrike, kanalizim dhe ujësjellës.

- **Arsyeja e tretë e eliminimit të OE ankuesit**: Tek pershkrimi i ofertes, analiza financiare keni dhene cmim140,688.00€,ndersa komisioni vleresues ka konstatuar se cmimi eshte 142,179.00 €, ju si OE eshte dashur te Ilogaritni edhe TVSH per 3 pozicionet e tjera (Uniformat, Fitim te planifikuar dhe Material), ju TVSH-n e keni llogaritur vetem ne paga.

Përgjigja e OE ankuesit për pretendimin e tretë: Arsyetimi i tretë i dhënë si ndryshim aritmetik më arsyetimin se nuk kemi kalkuluar tvsh sipas Ligjit mbi tatimin e shtuar. Nuk ka rregull ligjore që e rregullon çështjen e faturimit të tvsh në materialin higjienik, dhe në uniforma të punës sepsë të dyja këto janë pagësa të cilat OE pagun palëve të treta në këtë rastë si rregull tvsh është e ribursueshme nga ATK.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, OE ankuesi ka paraqitur nji përshkrim (Analizë Financiare), ku për uniformat nuk shkruan në Specifikacion DT që të llogaritet TVSH, gjerësa tek materiali OE ankuesi e ka llogaritur TVSH-në:

4. Përgjegjësitë e përgjithshme.

Ofertuesit janë të obligua që të sigurojnë personelin punonjës, mbikëqyrjen, pajisjet, mjetet, materialin shpenzues për pastrim, kemikalet, transportin dhe gjësendet tjera që janë të nevojshme për të kryer punët si kurse kërkohet në dokumentin ofertues.

Gjithashtu ofertuesit duhet të jenë përgjegjës për sigurimin e materialit pastrues, furnizimeve tjera, agjenteve për pastrim, materialeve dhe mjeteve tjera të specializuara si dhe transportimin e tyre në mënyrë që të bëjnë ekzekutimin e punëve në mënyrë sa me profesionale.

Ofertuesit duhet të jenë përgjegjës për të garuar uniformat dhe mbrojtësat e trupit, ne vender ku dhe si nevojiten duhet te furnizojnë uniforma mbrojtëse te cilat nuk do te kufizohen vetëm ne, doreza, syze mbrojtëse, maska per fytyre, çizme mbrojtese per shputa si dhe helmeta ne mënyrë qe ti përgjigjen kërkesave te standardeve evropiane per siguri dhe shëndet ne pune.

Përshkrimi i çmimeve i Materialit për Pastrimin							
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia Mujore	Numri i muajve (36)	Sasia Totale për 3 vite	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi ne total për 3 Vite
1	Letër përshirë 2 ply për duar (rollne dy shtresore për aparat)	Copë	30	36	1080	0.68	734.4
2	Letër tualeti 2 ply	Kom.1/10	30	36	1080	1.27	1371.6
3	Dezinfektues (Domestos apo Ekuivalent)	Copë	30	36	1080	0.84	907.2
4	Acid Chlorhydroic (HCl)	Litër	20	36	720	0.42	302.4
5	Detergjent I lëngshëm Vim	Copë	10	36	360	0.55	198
6	Material standard për pastrimin e dyshemesë së rëndomtë	Litër	60	36	2160	0.31	669.6
7	Material standard për pastrimin e dyshemesë së tualetit	Litër	10	36	360	0.31	111.6
8	Material për pastrimin dhe dezinfektimin e dyshemeve në Klasa,Salla,Kabinete dhe Zyra	Litër	16	36	576	0.17	97.92
9	Detergjente të posaqme pë xhama të dritareve	Litër	30	36	1080	0.48	518.4
10	Kese për Mbeturina-Ngjyra e zezë-Mbeturina të zakonshme 120 L	Kom. 1/10	35	36	1260	0.38	478.8
11	Kese për Mbeturina-Ngjyra e zezë-Mbeturina të zakonshme 60 L	Kom.1/10	40	36	1440	0.42	604.8
12	Material për pastrimin e lavamanëve dhe rubinetëve me mjete zbardhuese dhe lustrim	Litër	6	36	216	0.66	142.56
13	Sapun për duar i lëngshëm	Litër	20	36	720	0.39	280.8
14	Air fresh sprej 0.5 L	Copë	12	36	432	0.75	324
15	Air fresh për tualete	Copë	12	36	432	0.75	324
16	Aparata për letër me senzor (25 cm)	Copë	12	1	12	0.15	1.8
17	Aparata për terjen e duarve me senzor	Copë	12	1	12	0.15	1.8
		Totali i materialit për pastrim					7,069.68

Nga: Kompania e Pastrimit "efa Dienstleistung GmbH–Dega në Kosovë " me numer të biznesit 810804999 me address: Rr. "Rexhep Mala" Aktash .Nr.25 Prishtinë.

Për: UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

Lënda: ANALIZË FINANCIARE

Datë: 19.06.2020

Nr.	Paga Bazë	Trusti 5 %	Pushimi vjetor	Uniforma
1	290.00	101.50	169.17	3.50
2	360.00	18.00	30.00	0.50
3	360.00	18.00	30.00	0.50
4	2,750.00	137.50	229.17	
5	99,000.00	4,950.00	8,250.12	162.00

Pwrshkrimi i ofertes	
Pagat total	€ 112,200.12
TVSH	€ 20,196.02
Uniformat	€ 162.00
Fitimi I planifikuar	€ 1,060.18
Materiali	€ 7,069.68
totali	€ 140,688.00

Administrata e Kompanisë

Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e **gjenë pjesërishtë bazuar.**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "EL-Bau &Eing Com"SHPK dhe OE"Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan- Ri Tender"**, me numër të prokurimit: **941-20-2219-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankuesve të lartpërmendur të aprovohen pjesërishtë, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - **OE "EL-Bau &Eing Com"SHPK dhe OE"Efa Dienstleistung GmbH-Dega Kosovë"**